

Pozicioni: Imam i Xhamisë Shqiptare në Melbourne të Australisë

Punonjësi raporton tek: Bordi i Komitetit të Shoqatës Shqiptare Islamike Australiane

Historiku i organizatës tonë “AAIS”

Komuniteti Mysliman Shqiptar në vitin 1963 formoi Shoqatën Islamike Shqiptare Australiane (AAIS), e cila në vitin 1969 ndërtoi xhaminë e e parë në Melbourne të Australisë. Që nga ajo kohe e deri me sot AAIS vazhdon t'i shërbejë si komunitetit mysliman shqiptar ashtu edhe e komuniteteve tjera myslimane të Melbournit dhe rethinës.

AAIS është organizata më e madhe myslimane shqiptare në Australi me mbi 1000 familje anëtarë financiarë të kësaj shoqate. Drejtues i kësaj shoqate është Bordi i Komitetit të AAIS. Ky bodr përbëhet nga trembëdhjetë anëtarë financiarë vullnetarë të zgjedhur.

AAIS- shoqata Islamike Shqiptare Australiane ka gjithashtu një Komitet aktiv të Grave, dhe Grupin Rinor që kryesisht vepron në Qendrën Rinore të AAIS me lokacion në Truganinë, e cila qendër është e ndërtuar nga vetë anëtarët financiarë të AAIS dhe familjet e tyre dhe atë për shërbime sociale, kulturore dhe edukativo- arsimore.

Detyrat dhe roli i imamit

Imamit të xhamisë Shqiptare pranë AAIS i parashihen të kryej veprimet dhe aktivitetet që vijojnë:

- Të kryej obligimet e përgjithshme të një imami klasik intelektual dhe shkencor.
- Të mbaj udhëzime fetare- hutbe dhe ligjerata (sipas Shkollës – judirike Hanefite) për anëtarët financiarë të Shoqatës dhe familjet e tyre.
- Të angazhohet në mënyrë proaktive në promovimin e Islamit (sipas Shkollës së Mendimit Hanefi), kryesisht për anëtarët financiarë të AAIS-it, si dhe komunitetit më të gjerë, duke u angazhuar edhe në aktivitete që ndihmojnë dhe kontribuojnë në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të shqiptarëve mysliman në Australi.
- Imamit të Xhamisë Shqiptare do t'i kërkohet të punojë ngushtë me Bordin Ekzekutiv të AAIS.

Kualifikimet dhe aftësitë personale të konkuresve për këtë pozitë:

1. Të jetë me prejardhje myslimane shqiptare.
2. Të flasë dhe të shkruajë rjedhshëm në gjuhët: Shqipe Angleze dhe Arabe.
3. Të ketë kryer studimet e larta (terciare) islame pranë ndonjë institucioni islamik të akridetuar.
4. T'i përkas shkollës juridike hanefite.
5. Të ketë eksperiencë për të udhëhequr xhematin e xhamisë si Imam me profesionalizëm.
6. Të posedoj aftësi për të ligjruar dhe mësuar islamin; të riturve, të rinjeve dhe fëmijëve.
7. Të posdoj aftësi komunikuese - organizative dhe zotësi për të mbajtur fjalime publike.
8. Çertifikatë se nuk ka ndjekje penale dhe se nuk është në hetime nga autoritetet e shtetit përkatës.

Për të aplikuar, vizitoni faqen zyrtare të shoqatës www.aaais.org.au/careers ose skanoni kodin QR të mëposhtëm:

Aplikimet mbyllen me 23/01/2026

Për çdo informacion shtesë, ju lutemi na kontaktoni me email në: admin@aaais.org.au

Bordi Ekzekutiv i Komitetit të AAIS

